



# NEWSLETTER E DIASPORËS

PERFAQËSIMI DHE NXITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE NDËRVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT, DUKE NXITUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFLJVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHITETET KU ATA BANOJNË

#102

## TAKIMI/ Prezantohen 6 ekspertët e IOM për zbatimin e strategjisë për Diasporën 2021-2025



Ka filluar zbatimimi i planit të veprimit të “Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2021-2025”, ku në takimin më të fundit janë prezantuar 6 ekspertët të cilët do të mbështesin institucionet shqiptare në zbatimin e strategjisë.

Pjesë e takimit ishte edhe Ministri i Shtetit për Diasporën, Z. Pandeli Majko, i cili theksoi rëndësinë e zbatimit Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2021-2025.

“Qëllimi i këtij takimi është njohja e ekspertëve të ri të cilët do të jenë pjesë e Institucioneve dhe do të japin kontributin e tyre në zhvillimin e këtij plani. Secili prej ekspertëve do të realizojë takime me zv.Ministrat përkatës dhe do të vijoi punën me bashkëpunimin absolut nga ana e tyre. Ju të gjithë jeni një vlerë e shtuar e këtij projekti. Bisedimet mes nesh do të vijojnë për t'u informuar në vazhdimësi në lidhje me këtë projekt”, u shpreh Ministri Majko.



## "Apliko online për rinovimim e dokumenteve biometrike"

Të interesuarit për të drejtën e votës në migracion mund të marrin më shumë informacion në faqen e Web-it të Komisionit të Reformës Zgjedhore.

## REGJISTRIMET/ 2 mijë profesionistë pjesë e Rrjetit të Diasporës

Numri i regjistrimeve në Rrjetin Profesionit të Diasporës ka arritur në 2020 anëtarësime, që nga krijimi i saj në korrik të vitit të kaluar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit të Diasporë.

Ky rrjet është një platformë ku të gjithë profesionistë shqiptarë brenda dhe jashtë vendit, takohen niveli profesional dhe shkëmbimi i informacionit.


“Rrjeti i profesionistëve të Diasporës” është një platformë që synon të mbështesë e të nxisë transmetimin e të dhënave profesionale duke ofruar një urë lidhëse me kapacitetet profesionale të ndryshme në diasporë. Qëllimi i Platformës është të mbledhë dhe shkëmbejë informacione dhe përfshirjen e ekspertizës së anëtarëve të këtyre komuniteteve shqiptare në Diasporë dhe ti lidhë ato edhe me kërkesat e biznesit shqiptar apo të huaj në të mirë të zhvillimit të vendit. Ai synon në një fazë të dytë të shërbejë në gjenerimin e ideve dhe nismave nga komunitetet profesionale të Diasporës shqiptare.



## Vota e Diasporës Shqiptare

Të interesuarit për të drejtën e votës në migracion mund të marrin më shumë informacion në faqen e Web-it të Komisionit të Reformës Zgjedhore.

## QBD/ “Tregime të moçme shqiptare”, falas online botimi dygjuhësh shqip-frëngjisht



Në Ditën Ndërkombëtare të Librit për Fëmijë, (2 prill) Qendra e Botimeve për Diasporë sjell falas online përkthimin e rrëfimeve më të dashura nga letërsia shqipe për fëmijë, me autor Mitrush Kutelin. Përrallat e “Tregimeve të moçme shqiptare” vijnë në botimin dygjuhësh shqip-frëngjisht, përkthyer nga Evelyn Noygues dhe redaktuar nga Saverina Pasho në gjuhën franceze. Së shpejti dhe në shtyp.

“Tregime të moçme shqiptare” është pjesë e projektit të botimeve dygjuhëshe, ndërmarrë nga QBD-ja. Dhjetë tregime të përzgjedhura nga vëllimi “Tregime të moçme shqiptare”, me autor Mitrush Kutelin, të përkthyer në pesë gjuhë: anglisht, italisht, greqisht, gjermanisht dhe frëngjisht. Për ta shkarkuar ose shfletuar librin, kliko këtu.




Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen

## KOLANA/ QSPA sjell librin për veprën e Jeronim De Radës

Kolana e botimeve “Thesaurus” e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA) hapet me librin “Vepra historiko – filologjike dhe publicistike të De Radës”, e kuruar nga Profesor Jup Kastrati, me 905 faqe.

Ky libër është një përmbledhje e shkrimeve me karakter filologjik dhe historik të Jeronim De Radës, të shkruara në italisht në organe të ndryshme të kohës, të sjella në shqip nga studiuesi Kastrati, i cili me akribi të thellë shkencore e ka pajisur veprën me një bibliografi të pasur të De Radës dhe mbi De Radën.

Vepra plotësuar edhe me dokumente autentike të Kastratit që vërtetojnë zanafillat e punës së tij rreth 60-vjeçare mbi këtë figurë emblemë të kulturës arbëreshe. Kjo vepër, gjithashtu bën pjesë në nënkolanën “In memoriam” të autorëve që nuk janë më në jetë, punën e të cilëve do e risjellë për publikun QSPA gjatë viteve.



Connect Albania është një program që lehtëson angazhimin e Diasporës Shqiptare që jeton jashtë vendit në zhvillimin e vendit të tyre të lindjes si agjentë zhvillimi për të tërhequr dhe rritur investimet midis komuniteteve shqiptare dhe të huaja përmes mekanizmit online

## GREQI/ Oficerja koordinuese Joneda Dodaj takim me drejtorin e IOM në Greqi, sfidat e emigrantëve shqiptarë



Oficerja Koordinuese për Diasporën, znj. Joneda Dodaj zhvilloi një takim me Drejtorin e Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) në Greqi, njëkohësisht dhe Koordinator Rajonal i Organizatës, z. Gianluca Rocco.

Në fokus të takimit ishte rëndësia e rolit të postit të ri të Oficerëve të Diasporës në Republikën e Greqisë, ecuria e integritit të komunitetit shqiptar në shoqërinë greke, potencialet e projekteve të krijuara për angazhimin e diasporës shqiptare si dhe atyre që janë në proces zhvillimi, hapësirat dhe mundësitë e bashkëpunimit të shtetit shqiptar me Organizatën Ndërkombëtare për Migracionin në Greqi, si dhe përfshirjen e shoqatave/organizatave shqiptare në bashkëpunime të mundshme në të ardhmen, ku të dy palët shprehën vullnetin e mirë për bashkëpunim.

## Aplikacioni Gazeta "Diaspora Shqiptare"



App store: këtu Play store: këtu

## **Digjitalizimi i Veprave Shqiptare**



Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen

## **Dhuro Libro**



Nisma “Dhuro libra” do të shërbejë për krijimin e një fondi me libra shqiptarë në institucionet e vuajtjes së dënimit në Greqi dhe Itali.

**Për më shumë informacione nga Diaspora vizitoni  
[www.diasporashqiptare.al](http://www.diasporashqiptare.al)**